



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

**RAPORT I KONSULTIMIT PUBLIK PËR VITIN 2023 PËR MINISTRINË E
KULTURËS**

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (*pasqyra e statistikave kryesore mbi konsultimet e kryera me mësimet e nxjerra, sfidat dhe mundësitë*)

Gjatë vitit 2023, Ministria e Kulturës ka realizuar procesin e konsultimit publik për 1 (një) projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9616, datë 27.9.2006 "Për Librin në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, duke përbushur në masën 100% detyrimin për konsultim publik të akteve të miratuara, objekt i ligjit nr. 146/2014 për “Njoftimin dhe Konsultimin Publik”.

Procesi i konsultimit është kryer nëpërmjet publikimit në Regjistrin Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik si dhe aktiviteteve të tjera konsultative.

Nga analiza e kryer pas përfundimit të konsultimeve rezulton që ka pasur disa sugjerime të përcjella nga grupet e interesit. Kemi marrë komente/sugjerime nga shumë palë të interesuara, të ardhura kryesisht nëpërmjet takimit të grupit të punës dhe komenteve/sugjerimeve të ardhura prej tyre me postë elektronike. Një pjesë e këtyre komenteve/sugjerimeve janë përfshirë në procesin e vendimmarrjes, duke u integruar në tërësi në përmbajtjen e projektligjit. Ndërkohë nga monitorimi i regjistrit elektronik të konsultimit publik, rezulton se nuk ka pasur komente, përpos komenteve të shumta të grumbulluara në takimin konsultativ, ku pjesëmarrja e aktorëve të interesit ka qenë maksimale.

Nxitja e publikut për të rritur pjesëmarrjen në proceset e konsultimit publik mbetet një nga sfidat kryesore të gjithë administratës publike në drejtim të konsolidimit të konsultimit publik, si një hallkë thelbësore në zinxhirin e procesit të hartimit të legjislacionit.

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9616, datë 27.9.2006 "Për Librin në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar i është nënshtruar një procesi kompleks dhe të zgjeruar konsultimi publik me përfshirjen e aktorëve dhe grupeve të interesit të fushës në takime të drejtpërdrejta dhe një mase të gjerë qytetarësh nëpërmjet platformës online të njoftimit dhe konsultimit publik.

Procesi krahasuar me vitin e mëparshëm është përmirësuar, lidhur me diversifikimin e mjeteve të përdorura për konsultim, rritjen e aksesit të qytetarëve në konsultim.

Përforcimi i kulturës pjesëmarrëse dhe nxitja e publikut për të rritur përfshirjen në proceset e politikëbërjes publik mbetet një nga sfidat kryesore në drejtim të konsolidimit të konsultimit publik.

2. Analiza e Konsultimeve

2.1 Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike

Është kryer Konsultimi Publik për një projektakt i cili është miratuar, konkretisht: Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9616, datë 27.9.2006 "Për Librin në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.

2.1.1. Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në gjashtë mujorin e parë?

Gjatë vitit 2023 Ministria e Kulturës ka miratuar gjithsej 23 projektakte, 11 prej te cilave të parashikuara në Planin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve të vitit 2023.

2.1.2. Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?

Nga Ministria e Kulturës është konsultuar 1 akt, objekt i konsultimit publik, konkretisht projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9616, datë 27.9.2006 "Për Librin në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, konsultimi i të cilit është detyrim ligjor, sipas pikës 1, të nenit 1 të ligjit “Për konsultimin publik.

Ndërkohë aktet e tjera të miratuara që nuk hyjnë në kategorinë e projekt-dokumenteve strategjike kombëtare dhe vendore, si dhe politikave me interes të lartë publik, për t’iu nënshtruar detyrimeve që rrjedhin nga ligji “Për konsultimin publik”, por janë trajtuar me grupet e interesit të cilëve do t’u ndikonte në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë përmbytja e akteve, sipas rastit.

2.1.3. Sa ligje me raporte VNR-je janë konsultuar?

Për këtë periudhë është konsultuar projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9616, datë 27.9.2006 "Për Librin në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, i cili shoqërohet me raportin e vlerësimit të ndikimit (VNR).

2.1.4. Për sa akte në a) Programin Analitik, b) PKIE, c) dokumente strategjike të sektorit, janë përdorur kriteret/përjashtimet nga konsultimet publike? Cilat janë arsyet kryesore për të mos u konsultuar (nëse ka të tilla)?

Në PPAP janë përjashtuar (me anë të kriterëve përjashtuese) 10 akte. (Sqarojmë se këto akte kanë qenë Vendime të Këshillit të Ministrave, të cilat nuk kanë qenë dokumente strategjike)

2.1.5. Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, udhëzime, etj.)?

MK ka konsultuar 1 (një) projektligj me rëndësi strategjike

2.1.6. A është përmirësuar situata në krahasim me vitin e kaluar (cilësoni)?

Situata në krahasim me vitin e kaluar është përmirësuar. Në procesin e konsultimit janë përfshirë një numër i gjerë aktorësh, në disa platforma si RENjK, takime konsultative, e-mail dhe sugjerimet e tyre janë reflektuar si në raportin individual të konsultimit ashtu edhe në relacionin e dërguar në Këshillin e Ministrave duke pasqyruar nëse janë pranuar ose pse jo. Në krahasim me vitin 2022, hapat e procesit janë respektuar rigorozisht: Projektligji është konsultuar paraprakisht me institucione si; Shoqata e Botuesve Shqiptarë, Biblioteka Kombëtare Shqiptare, Akademia e Studimeve Albanologjike, Shoqëria e Librit Shqip, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Aleanca e Librit Shqip, të cilët përbëjnë dhe grupin kryesor të interesit në këtë projektligj. Grupeve të lartpërmendur iu prezantua nevoja për

ndryshime dhe përmirësime në kuadrin ligjor në fuqi në fushën e librit dhe u kërkua të parashtroheshin pikëpamjet, idetë në lidhje me ndryshimet e mundshme.

Më pas konsultimi vijoi me publikimin e projektligjit në sistemin e informacionit të qeverisë (RENjKP), si dhe është dhënë informacioni i mjaftueshëm lidhur me konsultimin e gjerë me grupet e interesit dhe janë ruajtur prova të mjaftueshme për reagimet e tyre nëpërmjet raportit individual. Janë organizuar takime konsultative me disa grupe interesi dhe me institucione që preken nga ndryshimet e propozuara.

2.2. Metodatat e konsultimit

2.2.1. Cilat ishin metodatat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistri elektronik, posta elektronike, faqe interneti, takime publike, komitete këshillimore, etj.)

Për të zhvilluar konsultimet publike u përdoren këto metoda:

a. Konsultimi paraprak; Me shkresën nr. 746 prot., datë 13.02.2023, një njoftim paraprak i është dërguar nominalisht institucioneve si; Shoqata e Botuesve Shqiptarë, Biblioteka Kombëtare Shqiptare, Akademisë së Studimeve Albanologjike, Shoqërisë së Librit Shqip, Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Aleancës së Librit Shqip të cilët përbëjnë dhe grupin kryesor të interesit në këtë projektligj. Me anë të shkresës së dërguar u prezantua nevoja për ndryshime dhe përmirësime në kuadrin ligjor në fuqi në fushën e librit dhe u kërkua të parashtroheshin pikëpamjet, idetë në lidhje me ndryshimet e mundshme. Nga ana e institucioneve të lartpërmendura nuk pati komente, sugjerime paraprake.

b. Konsultimi në portalin “Rregjistri Elektronik për Njoftimet dhe konsultimet Publike” për periudhën 02.11.2023 – 05.12.2023, gjatë së cilës nuk janë përcjellë komente përmes këtij protali, por në rrugë elektronike në adresën e e-mailit të koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik.

c) zhvillimi i takimeve publike. Më datë 24.11.2023 është organizuar takimi konsultativ nga Ministria e Kulturës në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Librit dhe Leximit, me përfaqësues të grupeve të interesit.

Për projektvendimin kemi marrë komente nëpërmjet takimeve të realizuara dhe dërgimit të komenteve nëpërmjet postës elektronike të kordinatorit për konsultimin publik. Nga konsultimet publike të kryera më së shumti kemi marrë komente/sugjerime nga takimet e realizuara dhe me postë. Nisur nga ky fakt, këto metoda konsultimi rezultojnë të jetë metoda më efikase.

2.2.2. Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?

Njoftimi dhe Konsultimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9616, datë 27.9.2006 "Për Librin në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar me anë të takimeve konsultative me grupet e ndryshme të interesit rezultoi metoda më efikase e konsultimit për projektaktin.

2.2.3. A organizoi institucioni konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nëse po, në sa raste?

Në hartimin e projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9616, datë 27.9.2006 "Për Librin në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në fazat e hershme të hartimit të tij, grupi i punës ka njoftuar paraprakisht institucionet si; Shoqata e Botuesve Shqiptarë, Biblioteka Kombëtare Shqiptare, Akademisë së Studimeve Albanologjike, Shoqërisë së Librit Shqip, Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Aleancës së Librit Shqip të cilët përbëjnë dhe grupin kryesor të interesit në këtë projektligj. Me anë të shkresës së dërguar u prezantua nevoja për ndryshime dhe përmirësime në kuadrin ligjor në fuqi në fushën e librit dhe u kërkua të parashtroheshin pikëpamjet, idetë në lidhje me ndryshimet e mundshme. Nga ana e institucioneve të lartpërmendura nuk pati komente, sugjerime paraprake.

2.3. Kohëzgjatja e konsultimeve

2.3.1. Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditë pune siç kërkohet nga ligji? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes së konsultimeve?

Projektligji ka qenë i publikuar në Regjistrin Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimit Publik (RENJK) për periudhën 02.11.2023 – 05.12.2023, Ndërkohë që përgjatë muajit nëntor, janë zhvilluar takime në kuadër të konsultimit.

2.3.2. Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?

Procesi i konsultimit është kryer duke respektuar afatet të cilat fillojnë që nga momenti i njoftimit, kryerjes së takimeve dhe afatit të lënë për marrjen e komenteve. Konkretisht, për projektligji ka qenë i publikuar në Regjistrin Elektronik për 33 ditë kalendarike. Ndërkohë që janë zhvilluar takime në kuadër të konsultimit përgjatë muajit nëntor.

2.3.3. A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Krahasuar me një vit më parë, kemi një gjenerim të konsiderueshëm të komenteve të ardhura nëpërmjet zhvillimit të takimeve dhe konsultimeve nëpër tryeza publike e takime. Konsultimi publik në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJK) për aktin e publikuar gjatë vitit 2023 u realizua në përputhje me parashikimin ligjor, për respektimin e afatit e kohëzgjatjes prej 20 ditësh pune duke filluar nga data e publikimit.. Situata edhe këtë vit është përmirësuar në kuadër të marrjes së kontributit dhe komenteve nga grupet e interesit, si rrjedhojë e bashkëpunimit efektiv dhe me strukturat teknike hartuese të akteve, të cilat kanë pasur më të lehtë identifikimin e grupeve të interesit të përfshira në dhënien e kontributit të tyre.

2.4. Palët e interesuara të përfshira

2.4.1 Sa aktorë të jashtëm, jo-qeveritarë morën pjesë për hartimin e akteve si anëtarë të caktuar të grupeve të punës/organeve këshillimore në vitin e caktuar?

Në grupin e punës për hartimin e projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9616, datë 27.9.2006 "Për Librin në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar nuk ka pasur aktor të jashtëm jo-qeveritarë.

2.4.2 Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individualë, OSHC, kompani, etj.)

Nuk ka pasur anëtarë të jashtëm.

2.4.3 Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultimet e hapura të realizuara për projekt-aktet në vitin e caktuar?

Në procesin e konsultimit publik ka marrë pjesë; Shoqata e Botuesve, Shoqata e Përkthyesve, Botues, Përkthyes, Ekspertë të Librit, Përfaqësues i Platformës Bukinist, Autorë. Shumica kanë përcjellë sugjerime të cilat i përkasin rregullimeve të tjera nënligjore dhe një pjesë e sugjerimeve kanë qenë të reflektuara në projektligj.

2.4.4 A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Numri i pjesëmarrësve ka qenë më i lartë se vitet e kaluara dhe numri i sugjerimeve të përcjella ka relativisht i lartë.

2.5. Rekomandimet dhe komentet e marra

2.5.1. Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdo konsultim?

Në konsultimin e realizuar për një projektakt janë marrë rreth 26 sugjerime.

2.5.2. Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?

Nga 26 sugjerime konkrete të përcjella 8 janë marrë në konsideratë plotësisht, një pjesë e komenteve kanë qenë të reflektuara në projektligj.

2.5.3. Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?

Në krahasim me vitin 2023 janë shtuar metodat e përdoruar për konsultimin publik duke përfshirë edhe atë paraprak.

2.5.4. Sa raporte të VNR-së janë ndryshuar/përditësuar në bazë të informacionit/të dhënave të marra gjatë konsultimit publik?

Projektligji është i shoqëruar me raportin e vlerësimit të ndikimit (VNR), i cili është ndryshuar pas konsultimit me departamentin përkatës në Kryeministri.

2.6. Raportet mbi rezultatet e konsultimit

2.6.1. Sa raporte konsultimi publikoi institucioni?

Raporti individual i konsultimit është publikuar në sistemin RENjK.

2.6.2. Nëse disa nuk u publikuan, cilat janë arsytet?

Nuk ka asnjë raport konsultimi të pa publikuar.

2.7. Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeksën e cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik

Si konkluzion konstatojmë se procesi i konsultimit të këtij projektakti ka rezultuar i suksesshëm dhe komentet e marra kanë shërbyer në përmirësimin e draftit të strategjisë. Vetëvlerësimi 8.

3. Sfidat dhe mundësitë për të ardhmen (Cilat janë sfidat kryesore në organizimin dhe zbatimin e konsultimeve në ministri dhe si duhet dhe do të adresohen ato në periudhën tjetër të raportimit?)

Sfida kryesore mbetet nxitja e publikut për të rritur pjesëmarrjen në proceset e konsultimit publik. Për të bërë të mundur rritjen e pjesëmarrjes së publikut, nëpërmjet dhënies së mendimeve/sugjerimeve kërkohet angazhimi i të gjitha institucioneve shtetërore, të përfshira në procesin e konsultimit. Mendojmë se për të përmirësuar procesin e konsultimit publik dhe për të siguruar një përfshirje sa më të madhe të publikut në këtë proces, është e nevojshme dhe zhvillimi i trajnimeve mbi procesin e konsultimit publik për të gjithë punonjësit që merren me hartim legjislativ.